



N. Prot. 284

Tiranë, 26/7/2024

**Kriteret dhe Procedurat e pranimit për Shtetasit Shqiptarë
në Programin e integruar të Studimit Master i Shkencave në Farmaci
Raundi i dytë, viti akademik 2024-2025**

Programi i integruar i Studimit Master i Shkencave në *Farmaci* ka një kohëzgjatje prej 5 vitesh akademike dhe zhvillohet në gjuhën italiane.

I. Kuotat dhe kriteret e pranimit

Në vitin akademik 2024-2025, kuotat e disponueshme të Programit të integruar të Studimit Master i Shkencave në *Farmaci*, në raundin e dytë janë:

- Për kandidatët shqiptarë:

Kandidatët duhet të kenë përfunduar shkollën e mesme dhe të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të kenë një Diplomë të Arsimit të Mesëm;
- të plotësojnë kushtin e notës mesatare të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave n.436, datë 03/06/2020, i modifikuar me VKM n.46, datë 27/01/2021 të Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës nota mesatare e shkollës së mesme për tu pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, në vitin akademik 2024-2025, **duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se 6,5**;
- të mos jenë të regjistruar njëkohësisht në programe të tjera studimi në të njëjtin vit akademik, në universitete publike dhe/ose private shqiptare dhe/ose të huaja.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nëpërmjet kriterit të mëposhtëm:

Vlerësim i Notës Mesatare të kurrikulës mësimore të Shkollës së Mesme.

Kandidatët do të listohen në renditje sipas rendit zbritës, bazuar në kriterin e Vlerësimit të Notës Mesatare të kurrikulës mësimore të Shkollës së Mesme. Renditja do të publikohet në mjediset universitare dhe në faqen zyrtare www.unizkm.al më datë **25 shtator 2024**. Kandidatët mund të përjashtohen nga renditja nëse konstatohen parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim në testet e pranimit.

Kreu. I - Kandidatët shqiptarë që aplikojnë për pranim në portalin U-Albania

I. Kryerja e aplikimit për pranim

Për të aplikuar për pranim në raundin e dytë, duhet të zgjidhni në portalin online U-Albania (<https://ualbania.rsimi.gov.al/>), Programin e integruar të Studimit Master i Shkencave në *Farmaci* në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", **në periudhën 19 shtator - 21 shtator 2024**.

II. Regjistrimi/ Matrikullimi

Kandidatët shqiptarë të shpallur fitues të raundit të dytë në bazë të renditjes së notës mesatare, duhet të regjistrohen pranë Sekretarisë Mësimore në periudhën **28 shtator - 7 tetor 2024**, sipas procedurave të



përcaktuara në shpalljen e raundit të parë. Siç parashikohet nga Dekreti Ministror n. 112 i datës 05.07.2024, i përditësuar, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, kjo periudhë është e ndarë në 5 faza nga 48 orë (28-29, 30-01, 02-03, 04-05, 06-07).

Për arsye të regjistrimit, kandidatët fitues të listuar në renditjen e Notës Mesatare (si dhe ndoshta kandidatët e përshtatshëm të pranuar për shkak të mosregjistrimit të fituesve) duhet të dorëzojnë në Sekretarinë Mësimore, personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të pajisur me një autorizim, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Faturën e pagesës bankare të këstit të parë ose të gjithë tarifës vjetore¹ (fletëpagesa mund të shkarkohet nga portali studentor: portal.unizkm.al, zëri: “Tarifat”);
- Diplomën e Shkollës së Mesme, kopje të noterizuar / Kopje të noterizuar të dokumentit të Njehsimit të Diplomës së Shkollës së Mesme të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore e Republikës së Shqipërisë, bashkë me Certifikatën e notave të Shkollës së Mesme të noterizuar;
- Certifikatë Mjekësore e Aftësisë për të studiuar;
- Certifikatë Vendbanimi;
- Certifikatë Familjare;
- Kopje e një dokumenti identifikimi të vlefshëm (kartë identiteti ose pasaportë);
- Dy foto.

Duhet gjithashtu të plotësojnë pranë Sekretarisë Mësimore:

- Aplikimin për Regjistrim (gjithashtu mund të shkarkohet nga Portali Studentor: portal.unizkm.al);
- Deklaratat e formuluar sipas Shtojcave **nr. 1 dhe nr. 2 të V.K.M. nr.12 dt.30.06.2023**
- Kontratën e regjistrimit;

Në momentin e regjistrimit, kandidati duhet të demonstrojë njohuri adekuate të gjuhës italiane duke kryer një test të njohjes së gjuhës italiane në Universitetin tonë. Pas regjistrimit parashikohet edhe një test për të verifikuar njohuritë e përgjithshme, i cili nuk do të ndikojë në renditjen e cila do të publikohet si gjithmonë, bazuar në notën mesatare të shkollës së mesme.

¹ Në rast se kandidati plotëson kriteret e përcaktuara në rregulloren e Tarifave të Studimit për të përfituar kontributin e studimit, shuma që duhet paguar do të reduktohet në raport me tarifën e mbetur.



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Heqja dorë nga studimet

Kandidati ka të drejtë të paraqesë kërkesë për të hequr dorë nga studimet në Sekretarinë Mësimore dhe të tërheq dokumentet e paraqitura gjatë regjistrimit **në datat 8 - 9 tetor 2024**. Nëse kërkesa nuk bëhet në këto data, kandidati nuk do të ketë më të drejtë të ndryshojë programin e studimit për vitin aktual akademik. Kërkesa për të hequr dorë nga studimet bëhet në portalin U-Albania dhe në Sekretarinë Mësimore.

Rektori

Prof. Leonardo Palombi

